



## Projekti: Përforsimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjore për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare

Shkup, 09.05.2017

### Këshillim mbi „Riorganizimin e debitorit në procedurën falimentuese – aspekte normative dhe praktika gjyqësore“

Në këshillimi e tetë dedikuar procedurës falimentuese, të mbajtur më 9 maj 2017 me temë „Riorganizimi i debitorit në procedurën falimentuese – aspekte normative dhe praktika gjyqësore“, të pranishmëve iu drejtua edhe ministri i ekonomisë, Driton Kuçi.

„Projekti përfshin kornizën ligjore për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare dhe mu për këtë ka rëndësi të jashtëzakonshme për Ministrinë e ekonomisë dhe ekonominë në përgjithësi. Projekti realizohet me ndihmën e Bashkimit Evropian, me mjete të Instrumentit për Asistencë Para-Aderimit (IPA) dhe në këtë kontekst – shënim i sotshëm i Ditës së Evropës, eventimenti i sotëm paraqet kontributin tonë simbolik ndaj shënimit të ditëlindjes së BE-së dhe një shenjë e determinimit tonë të fortë për përafrim më të shpejtë të vendit drejt anëtarimit të plotë në BE“, tha Kuçi, duke shtuar se rregullisht po ndiqen këshillimet dhe tryezat e rrumbullakëta në të cilat përfaqësues të institucioneve relevante debatojnë rreth aplikimit të rregullativës aktuale ligjore, të krijuar para një dekade, si dhe për ndryshimet dhe plotësimet e bëra në vitin 2014.



Sipas Kuçit, është konfirmuar vlerësimi për progresin e rëndësishëm në lejisllacion, por edhe për nevojën për zhvillim të mëtejshëm dhe harmonizim me direktivat evropiane dhe praktikatat e mira. „Dy direktivat e miratuara

deri më tani në këtë fushë dhe e treta – e cila ka të bëjë me sanimin dhe riorganizimin, për ne janë jashtëzakonisht të rëndësishme dhe paraqesin thirrje për angazhim aktiv në këtë drejtim. Andaj, harmonizimi me legjislacionin evropian kërkon edhe zgjerim të mëtejshëm të njohurive të likuidatorëve, për të përmirësuar aktivitetet e tyre, e në veçanti të administratorëve falimentues“, theksoi ministri i ekonomisë.

Të dhënat aktuale flasin për rreth 1800 procedura të hapura falimentuese, prej të cilave thuhet se 1000 janë pasojë e kontrolleve lidhur me fshirjen e shoqërive tregtare sipas detyrës zyrtare, dhe kjo paraqet sfida serioze për 60 administratorët e licencuar falimentues. Nga trajnimet profesionale për administratorë të ri falimentues, të paraparë me këtë projekt, pritet që për këtë profesion të shprehin interesim edhe shumë të rinj, të cilët njohuritë e tyre profesionale do ti drejtojnë drejt procedurave falimentuese, ndërsa administratorët ekzistues do t'i zgjerojnë njohuritë e tyre me trajnim të specializuar për riorganizim të shoqërive tregtare.



„Presim që të rritet edhe vetëdija ndaj rëndësisë së paralajmërimit të hershëm, për rëndësinë e fillimit të hershëm të proceseve të riorganizimit – pa marrë parasysh se a bëhet fjalë për periudhën parafalimentuese apo procedurën rrjedhëse. Në vendet e BE-së, sanimi po bëhet shumë i rëndësishëm, ndërsa modelet për realizimin e tij, edhe pse të shumëllojshëm, sërisht kanë qëllim të vetëm – kapërcimin e insolvencës dhe shpëtimin e të ardhmes së kompanisë, andaj vendet anëtare tani më sjellin zgjidhje të reja legjislative dhe në bazë të tyre përgatisin modele të planeve për riorganizim. Maqedonia nuk guxon të ngelet mbrapa në këtë rrugë!“, nënvizoi Kuçi.

Sipas tij, të gjitha këto elemente duhet të paraqesin mundësi edhe për veprim parandalues dhe shpëtim nga insolvenca e shoqërive tregtare tek ne. Në vend të stigmatizimit të falimentimit, pritet hartimi i legjislacionit, rezultati i të cilit do të jetë përmirësimi i mjedisit afarist, ruajtja e vendeve të punës, si dhe paralelisht, dalje më e shpejtë nga tregu e atyre që me veprimtarinë e tyre sjellin në rrezik dhe jolikuiditet shumë kompani të tjera.

Jam i bindur tha Kuçi se nga ky projekt i rëndësishëm, që po realizohet në suaza të Ministrisë së ekonomisë, do të përfitojë e gjithë ekonomia, ndërsa ndjekja e trendeve evropiane në perspektivë do të rezultojë edhe me zgjidhje të re legjislative e cila do të jetë përgjigje ndaj nevojave dhe kushteve në ekonominë tonë.

На советувањето претставниците на на Министерството за економија, стечајни управници, стечајни судии и судии кои работат на предмети што произлегуваат од стечајната постапка, како и претставници на други институции, имаа можност од излагањата на експертите Красин Димитров, Миодраг Ѓорѓевиќ и Дејан Костовски да се запознаат со нормативните аспекти и судската практика на стечајната реорганизација, европскиот контекст со најдобри практики, а беше претставен и концептуалниот модел на Spin Off реструктурирањето .

Riorganizimi tek ne është procedurë përmes së cilës gjendja e mirë financiare dhe qëndrueshmëria e firmës mund të ripërtrihen dhe të vazhdojnë funksionimi përmes më shumë mjeteve të përcaktuara me ligj. Nëse falimentimi shkon drejt shitjes, riorganizimi synon ringjalljen, ruajtjen e vendeve të punës, vlerës së pronës, krijimit të kushteve për realizimin e të ardhurave dhe pagesës së detyrimeve tatimore. Në vendet e BE-së, riorganizimi po bëhet gjithnjë më i rëndësishëm, ndërsa modelet për realizimin e tij, edhe pse të shumtë, mbeten me një qëllim të vetëm – kapërcimin e insolvencës dhe shpëtimin e të ardhmes së kompanisë.

Ristrukturimi Spin Off, si një nga modelet nënkupton transformim transparent të pronësisë, mundëson shlyerje më të volitshme të kërkesave të kreditorëve përmes procedurës tenderike, i obligueshëm për të gjithë pjesëmarrësit dhe është një proces i kontrolluar nga gjykata, dhe pas votimit, edhe nga ana e një personi të ngarkuar për mbikëqyrje të realizimit. Modeli Spin Off, përmes sanimit të firmave kyçe të mesme dhe të mëdha, mund të kontribuojë në rehabilitimin e ekonomisë dhe hapjen e vendeve të reja të punës në sektorin industrial. Përpilimi i planit për riorganizim dhe vetë realizimi i procedurës janë lehtësuar në masë të madhe për shkak të pjesëmarrjes aktive të kuadrit udhëheqës dhe punonjësve.

Projekti „Përforcimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjore për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare,“ realizohet me mjete të Instrumentit për Asistencë Para-Aderimit (IPA) të Bashkimit Evropian ndërsa zbatohet nga ana e konsorciumit të udhëhequr nga Pohl Consulting & Associates, në partneritet me Ernst&Young.